



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



**Datë:** 21.07.2025

**Numër Protokolli:**4908/2025

**A.nr.1010/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1010/2025, të datës 29.05.2025, të parashtruar nga ankuesi B.S, nga Graçanica, kundër organit të punësimit/Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.07.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Detyrohet** Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës Nr.14-117/01-0039829/25 të datës 20.03.2025 të parashtruar nga ankuesi B.S, dhe të nxjerrë nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**II.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.S (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 28.05.2025 përmes poste ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1010/2025 dhe numër protokolli:3616/2025, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në kërkesën e saj të datës 20.03.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 03.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 04.06.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 27.06.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:4425/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1010/2025 të datës 29.05.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:** Ankesa me numër protokolli 3616/2025 të datës 29.05.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 29.05.2025 dërguar nga ankuesi në Këshill; Kërkesën Nr.14-117/01-0039829/25 e datës 20.03.2025; Formulari i datës 20.03.2025; Akt Emërimit Nr.01-112-712 të datës 16.11.2024; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Kërkesë për përgjigje në ankesë 03.06.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 04.06.2025; Akt Emërimit e ankuesit të datës 01.02.2017; Vendimin e Kryetarit të Këshillit të datës 27.06.2025.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesit, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 20.03.2025 të parashtruar nga ankuesi, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2017 është i punësuar në Komunën e Prishtinës, në pozitën “Zyrtar për gjendje civile 2”, në kuadër të Drejtorisë së Administratës, ndërsa organi i punësimit me datë 16.11.2024 i ka lëshuar Aktin e Emërimit me shifër: 01-112-712, ashtu që pozitën e ankuesit “Zyrtar për gjendje civile”, e ka klasifikuar në Kategorinë Profesionale 2, me klasë dhe koeficient të pagës, GJ33, 5.1.

Ankuesi, me datë 20.03.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me kërkesën Nr.14-117/01-0039829/25, për kompensim material sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke iu referuar Aktit të Emërimit të lëshuar datë 16.11.2024 nga Komuna e Prishtinës/Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Po ashtu ankuesi në kërkesën në fjalë pretendon se është duke u paguar sipas koeficientit 4.50, GJ41-4 Profesional 3, ndërsa sipas shkresave të lëndës konstatohet fakti se organi i punësimit ka heshtur lidhur në kërkesën e ankuesit të datës 20.03.2025.

Kundër heshtjes administrative të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesi me datë 29.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimin ankimor se i njëjti është duke u dëmtuar financiarisht, pasi që pavarësisht faktit se organi i punësimit ia ka lëshuar Aktin e Emërimit me koeficient 5.1, i njëjti nuk është duke u kompensuar sipas koeficientit të ri, më kërkesën që organi i punësimit të zbatoj aktin e emërimit me shifër: 01-112-712 të datës 16.11.2024 dhe ta kompensojë sipas koeficientit 5.1 duke përfshirë kompensimin në mënyrë retroaktive që nga data 16.11.2024.

Këshilli në kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.06.2025 ndër tjerash kishte kërkuar prova dhe sqarime nga Komuna e Prishtinës, si në vijim: *“Dëshmi lidhur me ekuivalentimin/korrigjimin e koeficientit të ankueses; Dëshmi nëse organi i punësimit/Komuna e Prishtinës ka përfunduar klasifikimin e vendeve të punës; Sqarime të tjera dhe dëshmi lidhur me kërkesën e ankueses për kompensimin e pagës sipas koeficientit të përcaktuar me akt emërimit e datës 16.11.2024”*, kurse kjo e fundit në kërkesën e përcjellë me datë 04.06.2025 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, nuk kishte dhënë asnjë sqarim lidhur me kërkesën e cekur si më lartë.

Lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, meqenëse pala ankuese, me datë 20.03.2025 ka parashtruar kërkesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, atëherë Kolegji i Këshillit lidhur me obligimin e organit publik që të shqyrtoj kërkesën e palës dhe të nxjerr aktin administrativ, iu referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: *“3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar”*, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës”*, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative”*, në këtë rast, në kuptim të nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”*, dhe për rrjedhojë konstatoi, se organi të cilit i është drejtuar kërkesa, në rrethanat e rastit konkret Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është dashur të vendos brenda afatit prej 45 ditësh, apo të aplikohet neni 99 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo meqë kërkesa e palës ankuese nuk është shqyrtuar, atëherë është aplikuar heshtja administrative.

Sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast se organi publik hesht ndaj kërkesës së palës, atëherë palës i lind e drejta që të parashtrroj ankesë tek organi i shkallës më të lartë kundër heshtjes administrative duke u bazuar në dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”*, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse organi i punësimit ka heshtur ndaj kërkesës së ankueses, ankesa e ankueses e datës 28.05.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në kuadrin ligjor të cekur si më lartë, lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palës, e obligon Njësinë për Menaxhimin e Burimeve

Njerëzore të Komunës së Prishtinës, që të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës Nr.14-117/01-0039829/25 të datës 20.03.2025 të parashtruar nga ankuesi, në atë mënyrë që gjatë shqyrtimit të kërkesës të shqyrtohen të gjitha pretendimet e palës ankuese dhe të vendoset për të gjitha pretendimet në fjalë në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, sjell në vëmendje se Njësia për menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, gjatë shqyrtimit të kërkesës së datë 20.03.2025 të palës ankuese, duhet ta shqyrtoj faktin nëse akti mbi bazën e të cilit ankuesi i ka ngritur pretendimet për kompensim material, është lëshuar në pajtim me dispozitat e ligjit material, respektivisht Ligjit Nr.08/L197 për Zyrarët Publik si dhe Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

**Lënda, A.nr.1010/2025, datë 21/07/2025**

**Avdyl BEKTESHI**

Procesmbajtës

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit B.S;
- Komunës së Prishtinës (Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.